



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 127/8 prot.

Tiranë, më 30.6.2025

V E N D I M

Nr.28, datë 30.6.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT TË
VLERËSIMIT TË REZULTATEVE NË PUNË, PËR PERIUDHËN KORRIK -
DHJETOR, 2024, SI DHE ULJE NË KATEGORINË E POZICIONIT TË PUNËS
PËR NËPUNËSIN J. HOXHAI, NË INSTITUCIONIN E KONTROLLIT TË LARTË
TË SHTETIT**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën Korrik – Dhjetor, viti 2024 dhe ulje në kategorinë e pozicionit të punës, për nëpunësin Jonild Hoxhaj, në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni i dërguar me shkresat nr. 127 prot., datë 7.2.2025; nr. 127/4 prot., datë 16.6.2025; si dhe shkresën nr. 127/5 prot., datë 26.6.2025, të paraqitura nga nëpunësi Jonild Hoxhaj, në përmbajtje të së cilave ngrihen pretendime për parregullsi të kryera në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit Korrik - Dhjetor, viti 2024, për nëpunësin, gjatë ushtrimit të detyrës si “Auditues i Lartë”, Sektori i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit, në institucionin e Kontrollit të Lartë të

Shtetit, si dhe ulje në kategorinë e pozicionit të punës nga “Kryeauditues”, Sektori i Auditimit të Investimeve të Huaja, në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, në pozicionin “Auditues i Lartë”, ku aktualisht ushtron detyrën.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se, punonjësi Jonild Hoxhaj për periudhën e vlerësimit Korrik - Dhjetor, viti 2024, ka qenë i emëruar në pozicionin “Auditues i Lartë”, Sektori i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit, në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit në këtë pozicion pune, në zbatim të detyrimit të parashikuar në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, nga ana Zyrtarit Raportues, është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2024, konkretisht për periudhën Korrik - Dhjetor, viti 2024, për këtë nëpunës.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të arritjeve dhe rezultateve në punë, për periudhën Korrik – Dhjetor, viti 2024, nga ana e Zyrtarit Raportues, në datën 7.1.2025, nëpunësi është vlerësuar me nivelin 2 “Mirë”, ndërsa Zyrtari Autorizues e ka vlerësuar nëpunësin me nivelin 4 “Jo kënaqshëm”, në datën 7.1.2025.

Duke mos qenë dakord me vlerësimin, nëpunësi, në mbështetje të pikës 1, të kreut V, të VKM-së nr.109, datë 26.2.2014, ka kërkuar shqyrtim të vlerësimit nga Zyrtari Autorizues, nënshkruar në datën 10.1.2025.

Në vijim, Zyrtari Autorizues ka kryer procesin e rivlerësimit, duke e vlerësuar nëpunësin me të njëjtin nivel vlerësimi 4 “Jo kënaqshëm”, (në datën 13.1.2025), si dhe e ka njoftuar këtë të fundit për rezultatin e rivlerësimit, në datën 14.1.2025. Nëpunësi është shprehur se, nuk është dakord me vlerësimin, fakt të cilin e ka pasqyruar në plotësimin e pikës 2, të nëndarjes “DH”, të formularit të vlerësimit, duke deklaruar se do ta ankimoj në rrugë gjyqësore vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën Korrik- Dhjetor, viti 2024.

Për më tepër, në përmbajtje të këtij informacioni dhe të dokumentacionit bashkëlidhur tij, parashtrohet se, procedura e vlerësimit dhe rivlerësimit të rezultateve në punë nga ana e Zyrtarit Autorizues, është kryer në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, pasi, nuk janë respektuar elementët proceduralë, të cilët kanë ndikuar në arritjen e konkluzioneve të padrejta, në vlerësimin e performancës në punë të këtij nëpunësi.

Ndërsa për sa i takon përmbajtjes së procesit, pretendohet se, vlerësimi dhe rivlerësimi i kryer ka qenë i pa argumentuar dhe i pabazuar në një shqyrtim objektiv të rrethanave dhe ecurisë

së punës, ashtu si përcaktohet në kërkesat e akteve ligjore që rregullojnë këtë aspekt të zbatimit të ligjit, duke arsyetuar se mungojnë komentet nga ana e Zyrtarit Autorizues, në nëndarjen “DH”, të formularit të vlerësimit të rezultateve në punë, për punonjës, si dhe nuk përputhet niveli i vlerësimit ndërmjet Zyrtarit Raportues dhe Zyrtarit Autorizues.

Në këto kushte, punonjësi në fjalë, ka informuar Komisionerin nëpërmjet shkresave të evidentuara më sipër, ku ka parashtruar rrethanat e rastit dhe pretendimet e tij për paligjshmëri në veprimet administrative të Zyrtarit Autorizues.

Më tej, në zbatim të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri ka vlerësuar që të fillojë një proces verifikimi të informacionit, e për këtë arsye, nëpërmjet shkresës nr. 127/1 prot., datë 18.2.2025 “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të dërguar pranë Komisionerit me shkresën nr. 127 prot., datë 7.2.2025”, ka vënë në dijeni institucionin e KLSH-së, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm në të cilin materializohet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën Korrik – Dhjetor, viti 2024, për nëpunësin J. Hoxhaj, si dhe procedurën e ndjekur për nxjerrën e aktit nr. 818/16 prot., datë 30.7.2024, të Kryetarit të KLSH-së.

Në përgjigje të kësaj kërke, institucioni me shkresën nr. 259/1 prot., datë 25.2.2025, “Dërgim dokumentacioni për punonjës Jonild Hoxhaj”, të Sekretarit të Përgjithshëm, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 127/3 prot., datë 26.2.2025, ka paraqitur dokumentacionin përkatës për rastin konkret, duke përfshirë:

- Aktin e emërimit në detyrë të z. Jonild Hoxhaj, nr. 854/13 prot., datë 1.2.2014;
- Aktin e deklaramentit të statusit si nëpunës civil, nr. 854/15 prot., datë 1.2.2015;
- Formularin e Përshkrimit të Punës për pozicionin “Auditues i Lartë”, në Sektorin e Auditimit të Llogarive të Buxhetit të Shtetit, Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit;
- Vendimin nr. 145, datë 30.7.2024, i Kryetarit të KLSH-së, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 19, datë 31.1.2022 “Mbi miratimin e strukturës organizative të KLSH-së, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave, të ndryshuar”;
- Formularin e Vlerësimit të Punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2024 (Korrik – Dhjetor, 2024);
- Aktin e ndryshimit të kategorisë dhe Departamentit nr. 818/16 prot., datë 30.7.2024.

Njëkohësisht, Komisioneri me shkresën nr. 127/2 prot., datë 25.2.2025 “Kthim përgjigje në lidhje me informacionin e dërguar pranë Komisionerit me shkresën nr. 127 prot., datë 7.2.2025”, ka njoftuar nëpunësin se, informacioni i dërguar prej tij, do të trajtohet nga Komisioneri sipas përcaktimeve të Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit

Civil, i ndryshuar, duke e vijuar më tej komunikimin me njësinë përgjegjëse, pranë këtij institucioni, ashtu si e parashikon edhe ligji për nëpunësin civil.

Nga ana tjetër, në kushtet kur, ankimi pranë Komisionerit nuk është i parashikuar si një hallkë e ndërmjetme e ankimit administrativ, në këtë shkresë, Komisioneri ka sjellë në vëmendje të nëpunësit se, referuar nenit 41, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ai ka të drejtën që të ankohet drejtpërdrejt në gjykatën kompetente, që në rastin në fjalë është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, duke u kujdesur për të ruajtur afatin 45 ditor të ankimit.

Ndërkohë, nëpërmjet shkresës nr. 618 prot., datë 17.6.2025, Komisioneri ka komunikuar me institucionin e KLSH-së dhe njësinë përgjegjëse të këtij institucioni, duke i dhënë edhe orientime konkrete në lidhje me rastin në fjalë.

Në vijim, nëpunësi, me shkresën nr. 127/4 prot., datë 16.6.2025 dhe shkresën nr. 127/5 prot., datë 26.6.2025, i është drejtuar përsëri Komisionerit, me të njëjtin objekt, duke kërkuar të shprehet me vendim individual për rastin e tij.

Sa i takon objektit të kërkesës që ka lidhje me institutin e vlerësimit të performancës së nëpunësit civil, me të cilën nëpunësi i është drejtuar Komisionerit, sqarojmë se, sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë, është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Për realizimin e një vlerësimi sa më objektiv, në kuptim të pikës 12, kreut II, të vendimit nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, për realizimin e të cilit, *Zyrtari Raportues*, duhet të kalojë paraprakisht në tri fazat e mëposhtme:

- Planifikimi, ku Zyrtari Raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë Zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.

- Bisedimet e ndërmjetme. Në mes të periudhës së vlerësimit, Zyrtarët Raportues takohen me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.

- Vlerësimi përfundimtar, gjatë vlerësimit përfundimtar të rezultateve në punë, Zyrtari Raportues bën një vlerësim të përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.

Referuar, vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 109, datë 26.02.2014 “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, në kreun II “*Sistemi i Vlerësimit të Rezultateve në punë*”, pika 3, përcaktohet qartë se: “*Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues*”, duke respektuar fazën e planifikimit, fazën e bisedimeve të ndërmjetme dhe fazën e vlerësimit përfundimtar.

Ndërsa, në kreun I, pika 2, germat b), c) dhe ç), përcaktohen zyrtarët vlerësues në raport me strukturën organizative të institucionit, duke parashikuar se:

- “*Zyrtar Raportues*”, do të jetë nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin që do të vlerësohet;
- “*Zyrtar Kundërfirmues*”, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike Zyrtarin Raportues;
- “*Zyrtar Autorizues*”, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë Zyrtarin Kundërfirmues.

Ndërsa, sa i takon pretendimit të nëpunësit në fjalë, për ndryshimin e pozicionit të punës me një akt të titullarit të institucionit, shoqëruar kjo edhe me ulje në kategorinë e pozicionit të punës në shërbimin civil, duke analizuar përcaktimet ligjore e rregullative, konkretisht, ligjin nr.154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” dhe Rregulloren e Brendshme, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me Vendimin nr. 197, datë 12.10.2022 “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe dispozitat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në kushtet kur aktualisht ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të këtij ligji, konstatohet se, për shkak të natyrës së veçantë të punës që ka institucioni i KLSH-së, realizimi i procedurave administrative për disa aspekte të ligjit për nëpunësin civil, është i ndryshëm nga administrimi i shërbimit civil në institucionet e tipologjisë së zakonshme të sistemit të shërbimit civil.

Për këtë arsye, në këndvështrim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, mënyra se si është vepruar në rastet e ndryshimit të strukturës që kanë të bëjnë me

riorganizimin e shpeshtë të njësive organizative dhe lëvizjen e punonjësve nga një departament në tjetrin, sipas nevojave të momentit të auditimit, apo raste të tilla, kur nëpunësi, krahas detyrës që kryen, komandohet edhe në një detyrë tjetër, janë të ndryshme nga rregullimet e ligjit për nëpunësin civil, i cili kërkon një shërbim civil të qëndrueshëm, qëndrim ky i mbajtur nga Komisioneri edhe në Vendimin nr. 47, datë 26.7.2024 *“Për miratimin e Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes”*, për miratimin e Raportit Përfundimtar të procesit të mbikëqyrjes së zhvilluar në institucionin e KLSH-së, në përmbajtje të së cilit, Komisioneri ka vlerësuar se, për të përshtatur procesin e rekrutimit dhe mobilitetit (ristrukturimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë) të nëpunësve civilë në subjektin e mbikëqyrur (KLSH), me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil, kërkohe ndërhyrje në ligjin organik që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, si edhe në aktet e tjera rregullative.

Ndërkohë, nga përmbajtja e informacionit të dërguar, nga njësia përgjegjëse, pranë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përmes postës elektronike e-mail datë 26.6.2025, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 127/6 prot., datë 26.6.2025 rezulton se, nëpunësi J. Hoxhaj, ka ushtruar të drejtën e ankimit, për të gjitha pretendimet e tij, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të cilës i është drejtuar me kërkesë padi, duke kërkuar:

- ✓ Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit individual, formularit të vlerësimit të bërë sipas lidhjes nr. 2, të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014 *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, për nëpunësit e kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese, që ka vlerësuar në mënyrë përfundimtare me notën *“4 jo kënaqshëm”*, Audituesin e Lartë/ ish-Kryeaudituesin Jonild Hoxhaj, pikëzuar fillimisht me vlerësimin *“4 jo kënaqshëm”*, të datës 7.1.2025, si dhe rivlerësuar në datën 13.1.2025, po me notën *“4 jo kënaqshëm”*, bërë nga ana e KLSH, për rezultatet e punës në 6 - mujorin e dytë të vitit 2024;
- ✓ Rregullimin e pasojave duke detyruar palën e paditur të bëjë anulimin e vlerësimit dhe rivlerësimit të bërë nga ana e Kryetarit, si Zyrtar Autorizues me notën *“4 jo kënaqshëm”*, duke njohur dhe lënë në fuqi vlerësimin e bërë nga eprorët direkt që i korrespondon me rezultatin *“2 Mirë”*;
- ✓ Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ individual *“Ndryshim kategorie dhe departamenti”*, me nr. 818/16 prot., datë 30.7.2024, bërë nga ana e Kryetarit të KLSH;
- ✓ Rregullimin e pasojave duke detyruar palën e paditur të rikthejë Audituesin e Lartë Jonild Hoxhaj, në pozicionin e mëparshëm Kryeauditues, si dhe kthimin e diferencës së pagës mes pozicionit të mëparshëm Kryeauditues dhe atij aktual Auditues i Lartë, deri në momentin e ekzekutimit të vendimit;
- ✓ Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm;
- ✓ Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, referuar paragrafit 3, të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i cili sanksionon se, asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata, hetimi administrativ nuk mund të vijojë më tej, pasi rasti në fjalë do të zgjidhet në mënyrë përfundimtare nëpërmjet një vendimi gjyqësor ku do të rregullohen edhe pasojat e ardhura.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; të nenit 36, të ligjit nr.8116, dt. 29.3.1996 “*Kodi i Procedurës Civile*”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes së filluar kryesisht në mbështetje të informacionit të përcjellë me shkresat nr. 127 prot., datë 7.2.2025; nr.127/4 prot., datë 16.6.2025; si dhe shkresën nr. 127/5 prot., datë 26.6.2025, të dërguara nga nëpunësi Jonild Hoxhaj, pasi mosmarrëveshja është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe do të zgjidhet në themel nga gjykata kompetente.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe nëpunësi Jonild Hoxhaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha